



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 5, datë 03.02.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME POGRADEC

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Pogradec me:

Drejtues Ligjor Marsel Isallari
Drejtues Teknik Albert Tavanxhiu
Drejtues Teknik Ilir Vako

2. Operatori Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Pogradec autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura
Kategoria D, Për përpunimin e ujërave të ndotura

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Pogradec.
4. Kjo liçencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.27, datë 06.02.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 5, DATË 03.02.2017 “PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME
POGRADEC”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 06.02.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 5, datë 03.02.2017 “Për licencimin e sh. a Ujësjetllës Kanalizime Pogradec”

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Pogradec (**UK Pogradec**) me shkresën nr. 43 prot. datë 23.01.2020, me lëndë “Shkresë përcjellëse” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Pogradec për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Pogradec me vendimin nr. 5, datë 03.02.2017 “Për licencimin e sh. a Ujësjellës Kanalizime Pogradec, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Pogradec sh.a. z. Johan Sterjo, ka mbaruar studimet e larta në Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë në degën Histori.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Pogradec sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Pogradec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. Nr. 5, datë 03.02.2017 “Për licencimin e sh. a Ujësjellës Kanalizime Pogradec” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor z. Johan Sterjo”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani